



**VENDIM**

**Nr. 158, Datë 28.12.2015**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“ALBANIAN GENERAL ELETRICITY” SH.A., NË AKTIVITETIN E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “ç” 39 pika 3 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “P”; 5 pika 1, gërma “P”; 10 pika 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21 datë 18.03.2009 të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian General Eletricity” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Albanian General Eletricity” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gjerat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin shoqërisë “Albanian General Eletricity” sh.a, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**